



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevë Rrahim Morina, Kryesues i mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Malishevë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL- Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 04.08.2020 Nr.020-558
Zyrtaret përgjegjës: Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,


Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës për zëvendësimin e anëtarit në komitetin për planifikim urban, kadastër, mbrojtje të mjedisit, turizëm dhe monitorim të projekteve publike.

I miratuar më datë: 30.07.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.08.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Za:	Ragip Begaj, gradonačelnik opštine Mališevo Rrahim Morina, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS-a,
Od:	Venera Çerkini, direktorka Pravnog odeljenja i monitorisanje opština MLS
Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Ardita Latifi, viša službenica za monitorisanje opština
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo
Vrsta akta:	☐ Odluka

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje monitorisanje opština MLS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:


Odluka skupštine opštine za zemenu člana u odboru za urbano planiranje, katastar, zaštitu životne sredine, turizam i monitorisanje javnih projekata.
Usvojena dana, 30.07.2020. godine
Predložena na razmatranje u MLS-u dana, 04.08.2020. godine

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministartstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 272

Datë: 04.08.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 17, nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në nenin 26 paragrafi 3 dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, kërkesën nr. 02/251 datë:08.07.2020, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 30.07.2020 merr këtë:


V E N D I M

PËR ZEVENDËSIMIN E ANËTARIT NË KOMITETIN PËR PLANIFIKIM URBAN,
KADASTËR, MBROJTJE TË MJEDISIT, TURIZËM DHE MONITORIM TË PROJEKTEVE
PUBLIKE

1. Miratohet kërkesa nr.02/251 datë:08.07.2020 e parashtruar nga shefi i Grupit të anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje në Malishevë, për zëvendësimin (plotësimin) e anëtarit të ri në Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër, Mbrojtje të Mjedisit dhe Monitorim të Projekteve Publike.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi anëtarja e deritanishme znj. Jetmire Vrenezi, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin e Komunës së Malishevës, zëvendësohet me anëtarin Fjollë Krasniqi.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtares së emëruar znj. Fjollë Krasniqi janë të njëjta me anëtarët e tjerë të Komitetit.
4. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e vendimit nr.02/87 datë:10.04.2018 për emërimin anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Mbrojtje të Mjedisit dhe Monitorim të Projekteve Publik.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Anëtarëve të Komitetit.

Kryesuesi i Kuvendit
Edlir Morina





08.07.2020

02/251

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNES NË MALISHEVË



Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal në Malishevë, Rrahim Morina

Cc: Kuvendi Komunal në Malishevë

Nga: Alban Krasniqi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Malishevë

Lënda: KËRKESË për zëvendësimin (plotësimin) me një anëtar të ri të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Komitetin për Planifikim Urban, Kadaster, Mbrojtje të Mjedisit, Turizëm dhe Monitorim të Projekteve Publike.

Malishevë, 8 Korrik 2020

I nderuar,

Duke u bazuar në nenin 39 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 mbi të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit komunal, si dhe në ligjet dhe aktet nënligjore që përcaktojnë detyrat dhe obligimet e anëtarëve të Kuvendit Komunal, kërkoj:

Në cilësinë e anëtarit të Kuvendit Komunal në Malishevë dhe njëherit si shef i Grupit të Asambleistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në emër të subjektit politikë që përfaqësoj, kërkoj që të ndryshohet përbërja e Komitetit për Planifikim Urban, Kadaster, Mbrojtje të Mjedisit, Turizëm dhe Monitorim të Projekteve Publike. Më konkretisht kërkoj që anëtarja dhe njëherit kryesuesja e deritanishme e këtij komiteti, Jetmire Vrenezi, të zëvendësohet me anëtarin e re Fjollë Krasniqi e cila po ashtu njëherit do të jetë edhe kryesuese e re e këtij komiteti.

Arsyeja e këtij zëvendësimi është nga se anëtarja e deritanishme Jetmire Vrenezi, për shkak të angazhimeve profesionale të saj, ka deklaruar se e ka të pamundur të vazhdojë angazhimin e saj në komitetin në fjalë. Ndaj, duke pas parasysh rëndësinë e këtij komiteti, ne si subjekt politik, kërkojmë që të bëhet ky zëvendësim i antares sonë, pra Fjollë Krasniqi të marrë rolin e kryesueses së komitetit dhe kështu të rifunksionalizohet puna dhe aktivitetet e komitetit të cilat vërehet se kanë ngecur për një periudhë të gjatë.

Duke ju falënderuar paraprakisht pres përgjigjeje sa më të shpejtë në këtë drejtim dhe aprovimin e kësaj kërkesë.

Me respekt,

Për kontakt: e-mail albankras@gmail.com

Nr. Tel: 044-191-534



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

HYRJE DUAZNA-INCOMING			
KOSOVA E KOSOVES REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES YLLA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministère de l'Administration Locale Ministry of Local Government Administration			
Data Date		14.04.2018	
Përshkrimi i punës Description of work		Nr. i Javës Week No.	
- VI - 020 - 446			

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ *87*

Datë: 10.04.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 pika d, nenin 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në nenin 26 paragrafi 26.2 dhe 29 paragrafi 29.1 pika d) të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 04.04.2018 merr këtë:

VENDIM

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR,
MBROJTJE TË MJEDISIT, TURIZËM DHE MONITORIM TË PROJEKTËVE PUBLIKE

1. Miratohet vendimi për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, mbrojtje të Mjedisit, Turizëm dhe monitorim të projekteve publike në Komunën e Malishevës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi përbërja e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, mbrojtje të Mjedisit, Turizëm dhe monitorim të projekteve publike do të jetë prej pesë (5) anëtarëve:
 - 2.1. anëtar nga radhët e Nisma-Socialdemokrate
 - 2.2. anëtare (femër) nga radhët e Nisma-Socialdemokrate
 - 2.3. Florentina Zulfaj - anëtare nga radhët e PDK-së
 - 2.4. Fatmir Ademaj - anëtar nga radhët e LDK-së
 - 2.5. Jetmirë Vrenezi - anëtare nga radhët e VV-së
3. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e vendimit nr.02/44 datë:07.03.2018 për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, mbrojtje të Mjedisit, Turizëm dhe monitorim të projekteve publike, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 28.02.2018.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kuvendi përmes Kryetarit të Komunës dhe drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit të autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nën 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi duhet të:
Arkivohet në Komunën
MAPL-87

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahun Morina